

Hapet Thirrja për Bursa për Stafin Akademik për Mësimdhënie të Universitetit të Tiranës në Programin Erasmus + në Universitetin e Pavia, në Itali.

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në Universitetin e Pavia, në Itali.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie

Kohëzgjatja e bursave:

- Shkëmbimi i stafit akademik për mësimdhënie, 5 ditë plus 2 ditë udhëtim, në periudhën 21 nëntor 2016 – 31 Korrik 2017 (minimumi 8 orë mësimdhënie në javë)

Fushat e studimit:

- Matematikë, Fizikë dhe Shkencat e Natyrës
- Ekonomik
- Drejtësi
- Gjuhë të Huaja dhe Filozofi
- Shkenca Politike
- Psikologji
- Studime Komunikimi

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin ditor (140 EUR në ditë për stafin)
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Procedura e Aplikimit dhe Dokumentat e Nevojshme për Aplikim:

- Kandidati i interesuar për zgjedh një pedagog nga departamenti respektiv në Universitetin e Pavia për të shprehur interesin për të kryer një periudhë shkëmbimi duke dërguar përmes e-mail CV e tij/saj për të treguar fushën e ekspertizës dhe si të dy universitetet mund të përfitojnë nga ky aktivitet. Ju mund të gjeni të dhënat e kontaktit në adresën e website <http://www.unipv.eu/site/en/home/international-relations/erasmus--overseas/teaching-staff.html>
- Kandidati duhet të plotësojë dokumentin “Mobility agreement/Teaching programme” duke u konsultuar me pedagogun e përzgjedhur mbi aktivitetet që do të zhvillojë gjatë periudhës të shkëmbimit.
- Kandidati duhet të plotësojë aplikimin online në adresën <https://unipavia.pandaform.com/pub/qbhtx2/new>

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- CV
- Dokumenti “Mobility agreement (teaching programme) i firmosur nga aplikanti dhe departamenti i Universitetit të Pavia dhe Universiteti i Tiranës***
- Një kopje të dokumentit të identifikimit (pasaportë)
- Vërtetim punësimi në Universitetin e Tiranës

*** Mobility agreement/teaching programme për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj dhe nga Universiteti i Parias.

KUJDES! Kur të sillni në rektorat planin e mobilitetit për t'u firmosur nga Z. Skendaj, duhet të bashkangjisni edhe dokumentin e vërtetimit nga dekani i fakultetit tuaj që ju lejon të shkëputeni gjatë kohës së mësimdhënies për të kryer mobilitetin nëse shpalleni fitues.

Për të shkarkuar formatin e Mobility agreement/teaching programme ju lutemi vizitoni <http://www.unipv.eu/site/en/home/international-relations/erasmus--overseas/teaching-staff.html>

Afati për aplikim: deri më datë 11 Nëntor 2016 (ora 12pm, sipas orës së Italisë)

Per te aplikuar ju lutemi vizitoni
<https://unipavia.pandaform.com/pub/qbhtx2/new>

Gjithë aplikimi është online.

Për më shumë informacion mbi bursat vizitoni
<http://www.unipv.eu/site/en/home/international-relations/erasmus--overseas/teaching-staff.html>
ose mund të na kontaktoni në adresën iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin Tuaj.